



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**



**V E N D I M**

**Nr. 25, datë 18.4.2019**

**PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 18.4.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 35 pika 1 shkronja “d”, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 20 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat statndarte të zbatimit të buxhetit, udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.1.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, udhëzimin nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj, Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm të agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 4.12.2017, program i bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar në datë 24.10.2016, Marrëveshja e bashkëpunimit për zbatimin e projektit DEAR-CSO-LA/2017/388-138, ndërmjet rajonit Emilia-Romagna dhe bashkisë Shkodër nr. 15759 prot, datë 26.9.2018, Kontratat e grantit ndërmjet Bashkimit Europian të përfaqësuar nga Komisioni Europian në rolin e autoritetit kontraktues-njëra palë, rajonit Emilia-Romagna në rolin e koordinatorit të projektit si dhe partnerët e përfshirë në projekt, nga ku edhe bashkia Shkodër –pala tjetër, me nr. 15759 prot, datë 26.9.2018, VKB nr. 82, datë 20.12.2018 “për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të bashkisë Shkodër, pas diskutimeve,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të bashkisë Shkodër “Projekti DEAR-“Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdhatë migrimit dhe refugjatëve, udhëhequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138”, me burim financimi donacion nga Bashkimi


European, në kuadër të programit DEAR-EuropeAid/151103/DH/ACT/Multi, në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, shuma **57,010 Euro** (pesëdhjetë e shtatë mijë e dhjetë) konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të ditës që transferohen fondet si më poshtë:

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali (lekë)	Nga kjo				
		Paga	Sigurime shoq+shend.	Shpenzime operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
<b>Shuma 2019</b>	<b>4,758,386</b>	1,379,871	230,439	1,665,654	1,297,422	185,000
<b>Shuma 2020</b>	<b>2,303,393</b>	439,967	73,474	1,789,952	0	0
<b>Shuma totale e Projektit e financuar nga programi</b>	<b>7,061,779</b>	1,819,838	303,913	3,455,606	1,297,422	185,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 18.4.2019  
Shpallur në datën 19.4.2019

Sekretar i këshillit

  
Suel Hadri

KRYETAR

